


Për: Dardafon net. LLC (Z Mobile)
Fshati Miradi e Epërme
11000 Fushë Kosovë, Kosovë
Në vëmendje të:
Milot Gjilkolli, Drejtor dhe Agjent i Regjistruar

Prej: Bedri Istrefi, Kryeshef Ekzekutiv i Telekomit të Kosovës SH.A
Në kopje elektronike:
Bordit të Drejtorëve të TK SHA

CC: Menaxhmentit Ekzekutiv të TK SHA
Valon Basha, Këshilltar ligjor

Tema: Njoftim

Data: 30.07.2019



I nderuari Gjilkolli,

Më lejoni që me autorizimin e dhënë nga Bordi i Drejtorave, fillimisht t'ju rikujtoj disa fakte të cilat, besoj i keni të njohura.

- 1) Telekomi i Kosovës SH.A. (më tutje "**Telekomi**") dhe Dardafon.net L.L.C. (më tutje "**Dardafoni**") kishin nënshkruar "Marrëveshjen për Mbështetje" (më tutje "**Marrëveshja**") me dt. 16 Janar 2009;
- 2) Kohëzgjatja e Marrëveshjes ishte e kushtëzuar ekskluzivisht me kohëzgjatjen e Licencës së Telekomit nr. 111/04 të dt. 30 Korrik 2004 të lëshuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse – Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit e cila skadonte më 30 Korrik 2019 dhe me të cilën datë skadonte edhe kohëzgjatja e Marrëveshjes;
- 3) Për përfundimin e Marrëveshjes me datën 30 Korrik 2019 dhe në kuptim të obligimit ligjor, Telekomi e ka njoftuar Dardafonin zyrtarisht me datën 24 Qershor 2019, apo më shumë se 1 (nje) muaj më heret;
- 4) Në kuptim të nenit 3 te Marrëveshjes, ekipet negociatore të Telekomit dhe Dardafonit kishin zhvilluar negociata për arritjen e ujdisë për termat e një Marrëveshje eventuale të re për plotë 6 (gjashtë) muaj;
- 5) Të gjitha takimet e ekipeve negociuese, pa përjashtim, ishin të inicuar nga Telekomi dhe asnjëra nga këto takime nuk u inicua nga Dardafoni;
- 6) Gjatë periudhës 6 (gjashtë) mujore të negociimeve dhe për dallim nga Dardafoni, ishte vetem Telekomi palë e cila kishte dhënë propozime konkrete për arritjen e pajtueshmerisë rreth nënshkrimit të një Marrëveshje të re eventuale;



Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

- 7) Vet fakti i dërgimit të "Përgjigjes në ofertën komerciale të datës 18 Korrik 2019" me datën 29 Korrik 2019, në orët e vona pasdite dhe vetëm 1 (një) ditë para skadimit të afatit negocues, dëshmon qasjen Tuaj destruktive ndaj gjithë procesit negocues e posaqërisht ndaj Telekomit – partnerit Tuaj afarist, duke e dëshmuar për të satën herë shkeljen e parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë dhe shkeljen e parimit të mirëbesimit për të cilin vet jeni zotuar në Marrëveshje.

Ju rikujtoj se qasja e Juaj destruktive e përcjellë me shkelje brutale të parimeve të mirëbesimit, ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, u dëshmuua edhe me veprimet tjera konkrete të cilat i kishit ndërmarrë në fazën finale/kritike të negocimit:

- 8) Me datën 21 Qershor 2019, pa asnjë njoftim paraprak dhe në fshehtësi të plotë nga Telekomit, Dardafoni kishte aplikuar për Licencë për operatorin e tretë të Telekomunikacionit pranë Rregullatorit – ARKEP, përkunder detyrimit kontraktues për negociata me mirëbesim në statusin e MVNO. Për këtë veprim Tuajin, Telekomit kuptoj nga mediat;
- 9) Në përfundimin e periudhës 6 (gjashtë) mujore të negocimit, Dardafoni kishte shpallur haptazi qëllimin për vazhdimin e afatit të negocimit, me arsyetimin e "kohës së shkurtër për përgjigje ndaj ofertës së datës 18 Korrik 2019". Prapa këtij propozimi identifikohet qëllimi i vërtet i Dardafonit që me shtyerjen e afatit ta krijoj gjendja faktike e cila do mund të interpretohet si pelqim i Telekomit për vazhdimin e Marrëveshjes së datës 16 Janar 2009;

Kurse sa i përket "afatit të shkurtër", Ju rikujtoj se Telekomit Ju dërgoj ofertën komerciale plotë 12 (dymbëdhjetë) ditë para skadimit të afatit për negocim. Dhe Ju, prej 12 (dymbëdhjetë) ditëve në dispozicion, përgjigjen e bllokuat plotë 11 (njëmbëdhjetë) ditë duke e dërguar të njëjtën me një element të kundëroftës, vetëm 1 (një) ditë para skadimit të saj;

- 10) Me datën 08 Korrik 2019 dhe vetëm disa ditë para skadimit të afatit negocues, Dardafoni inicioi procedurën e përmbarimit të Vendimit përfundimtar të Tribunalit të Arbitrazhit 20990/MHM të dt. 09 Dhjetor 2016, duke e ditur se përmbarimi do e sillte Telekomin në situatë të papërbalueshme financiare, e me qëllim të dobësimit maksimal të pozicionit të Telekomit në fazën më të ndieshme/kritike të negocimeve.

Sa i përket "Përgjigjes në ofertën komerciale të datës 18 Korrik 2019" të cilën e keni dërguar me datën 29 Korrik 2019 në orët e vona pasdite, përmbajtja e saj vetëm sa e dëshmon qasjen e Dardafonit me keqbesim gjatë tërë procesit negocues, për këto arsye:

- 1) Duke e filluar secilën prej 20 (njëzet) pikave me fjalinë "Me kërkesën Tuaj...", Ju dëshmuat konstatimin nga pika 6 më lartë se ishte vetëm Telekomit palë e cila ka qenë më se konstruktive duke dërguar oferta dhe propozime konkrete dhe se Dardafoni për 6 (gjashtë) muaj nuk e dërgoj asnjë ofertë/propozim konkret;



Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

- 2) Nga gjithësjaj 20 (njëzet) propozime të Telekomit, në mënyrë absolute i refuzuat plotë 17 (shtatëmbëdhjetë) sosh, respektivisht 85% të tyre dhe ate, vetëm 1 (një) ditë para skadimit të afatit të negociimit;
- 3) Në asnjërin prej 17 (shtatëmbëdhjetë) refuzimeve, nuk ofruat asnjë arsy valide por refuzimet i bazuat në vlerësimet paushalle dhe të paargumentuara;
- 4) Insistimi i Dardafonit për ta patur raportin financiar të Telekomit të përgatitur nga "Mazars" është i pakuptimtë dhe i paarsyeshëm sepse:
 - a) Është e drejtë legjitime e secilës palë afarise që për nevojat e veta ta kërkon ekspertizën e jashtme profesionale;
 - b) Ekspertiza e "Mazars" ishte porositur vetëm nga Telekomit, andaj Telekomit nuk kishte asnjë detyrim që tërë ekspertizën t'ia ofron në disponim as Dardafonit dhe as kujdo qoftë tjetër;
 - c) Ekspertiza financiare është pronë e "Mazars" i cili i ka të mbrojtura të gjitha të drejtat autoriale dhe vetëm me lejen e tij, kjo ekspertizë apo një pjesë e saj mund t'ju zbulohet personave të tretë;
 - d) Duke iu qasur me mirëbesim të plotë procesit negociues, Telekomit ka aritur ta marrë lejen nga autori "Mazars" për t'ju shpalosur "Përmbledhjen" të cilën edhe Ju kemi përcjellë dhe nga e cila keni mundur të kuptoni se cilat ishin konstatimet kryesore të kësaj ekspertize.
- 5) Në paragrafin e parafundit, keni dhënë një "kundërofertë" vetëm për ndarjen e të hyrave, duke propozuar 33% për Telekomit dhe 67% për Dardafonin, me një mundësi shtesë për diskutim rreth alternativës – ndarjes në nivelin e barabartë. Me këtë propozim, jo vetëm se synoni ta cenoni parimin e ekuivalencës së prestimeve, por fitohet përshtypja se keni ngatëruar statusin e MVO me MVNO;
- 6) Përfundimisht, Telekomit vlerëson se qëndrimi refuzues i Dardafonit ndaj të gjitha propozimeve kualitative dhe kryesore të Telekomit pa asnjë arsy valide, "kundëroferta" e Dardafonit për ndarjen e të hyrave e cila është ndërtuar në kundërshtim me parimin e ekuivalencës së prestimeve dhe skadimi i afatit të negociimeve, objektivisht e pamundësojnë arritjen e çfarëdo Marrëveshje të re;

Rrjedhimisht, më lejoni t'ju njoftoj se:

Të gjindur ne pozitën faktike të përshkruar si më lartë e cila është krijuar si pasojë e drejtëpërdrejtë e veprimeve/mosveprimeve të Dardafon-it në kundërshtim me parimin e mirëbesimit, për të cilin ishte zotuar në Marrëveshjen e datës 16 Janar 2009 dhe në kundërshtim edhe me parimet tjera të legjislacionit aktual të Republikës



Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

së Kosovës të cekura më lartë, dhe nisur nga fakti i skadimit të afatit të kontraktuar 6 (gjashtë) muaj për negociim pa asnjë rezultat konkret dhe kualitativ, Telekomit Ju njofton se i shpallë negociatat si të përfunduara pa sukses.

Nga data 31 Korrik 2019 përfundojnë të gjitha raportet kontraktuese mes Telekomit dhe Dardafonit, përpos detyrimeve të parapara me nenin 13 të Marrëveshjes së datës 16 Janar 2009 që i referohen "Periudhës transitore".

Andaj, Ju lutem që nga data 31 Korrik 2019, bashkarisht ti ndermarrim të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të detyrimeve në "Periudhën transitore".

Ju lutem që këtë letër ta shpërndani në dijeni të stafit relevant të Dardafon dhe komisionit të juaja negocijator.

Respekt,